

Nr. i Dokumentit: 28.06.2017-01

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË MINISTRISË SË
ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016

Prishtinë, qershor 2017

Deloitte Kosova sh.p.k. ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ('Ministria') për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, në emër të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Deloitte Kosova sh.p.k. ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	19
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	20
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	23
Shtojca IV: Komentet e OB-së për të gjeturat e raportit të auditimit.....	25
Shtojca V: PFV	37

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Deloitte Kosova sh.p.k. ka kryer auditimin e pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (‘Ministria’) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016, në emër të Zyrës Kombëtare të Auditimit (‘ZKA’).

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Ministrisë për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Deloitte Kosova sh.p.k. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 28/03/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga ne për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kualifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të efekteve të çështjeve të pasurisë, të përshkruara në paragrafin ‘Baza për opinion të kualifikuar’.

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Ministrin dhe ekipin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi ‘Plani i Jashtëm i Auditimit’ është zëvendësuar i termut ‘Memorandumi i Planifikimit të Auditimit’.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Kualifikimi i Opinionit pasqyron dobësitë në kontrolle për ta konfirmuar vlerësimin e pasurisë.



Ministri duhet t'i analizojë arsyet për Kualifikim të Opinionit për vitin 2016 dhe t'i identifikojë veprimet që kërkohen për të mundësuar një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurisë në 2017 (shih çështjen 7).

Megjithëse vërehen përmirësime në procesin e vetëvlerësimit dhe përgjigjet ndaj rekomandimeve të vitit paraprak, këto prapë nuk janë adresuar plotësisht siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e Ministrisë.



Ministri duhet ta përmirësoj më tutje procesin dhe të sigurohet që procesi i vetëvlerësimit dhe rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive në baza të rregullta (shih çështjet 1, 2 dhe 4).

Realizimi i buxhetit për vitin 2016 ishte 96%, me një përmirësim prej 11% krahasuar me vitin paraprak.



Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkangjitura të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ("Ministria") të cilat përmbajnë Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme dhe Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, dhe shënimet sqaruese të përfshira në Shtojcën V të këtij raporti.

Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të mundshme të çështjeve të përshkruara në paragrafet të seksionit *Baza për Opinion të Kualifikuar*, pasqyrat financiare të Ministrisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016 janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me SNKSP për "Raportimin Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme" dhe me Ligjin Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr 03/L-048 i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

Baza për Opinion të Kualifikuar

Regjistri i pasurive kapitale. Shuma totale e pasurive që është paraqitur më datë 31 dhjetor 2016, në Shënimin 19.3.1: Pasuritë kapitale (me vlerë mbi 1,000 €) në posedim të organizatës buxhetore janë 348,531 euro. Meqë balanca prej 7,024,860 euro e prezantuar në pasqyra financiare të vitit 2015, gabimisht përbëhej edhe nga investime kapitale të kryera në komuna, Ministria kishte marrë masa dhe gjatë vitit 2016 ka bërë korrigjimet përkatëse. Megjithatë, edhe pas përmirësimeve të përcaktuara, ne identifikuar një diferencë prej 59,150 euro, në mes të vlerës së paraqitur në raportin financiar dhe vlerës sipas raportit mbështetës të bartjeve të pasurive për vitet paraprake. Rrjedhimisht, ne nuk ishim në gjendje të marrim dëshmi të mjaftueshme adekuate në lidhje me këto korrigjime në balancën e pasurisë kapitale më 31 dhjetor 2016.

Për më tepër, rezultatet e inventarizimit të pasurisë jo-financiare, të cilat do mund të mbështesnin saktësinë e lëvizjeve më sipër, nuk janë azhurnuar tërësisht në sistem. Rrjedhimisht, ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nëse ndonjë korrigjim është i nevojshëm në balancën e paraqitur në shpaloshjen 19.3.1 dhe 19.3.2 dhe balancat tjera të lidhura

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit tonë *Përgjegjësitë e Auditorit në Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Ministria, në përputhje me Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kodin e Etikës të Kontabilistëve për Kontabilistët Profesionistë (Kodi IESBA) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të modifikuar.

Çështje për t'u theksuar - Baza e Kontabilitetit

Ne tërheqim vëmendjen për "Deklaratën për Prezantimin e Pasqyrave Financiare", e cila përshkruan bazën e kontabilitetit. Pasqyrat financiare janë përgatitur për të plotësuar kërkesat e Ligjit Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr 03/L-048. Opinioni jonë nuk është i modifikuar për këtë çështje.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe atyre që janë Ngarkuar me Qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik ("SNKSP") për "Raportimin Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme" dhe me Ligjin Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048 i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194 dhe Ligjin nr. 05/L-007. Kjo përgjegjësi përfshin dizajnimin, implementimin dhe mbajtjen e kontrolleve të brendshme relevante për përgatitjen dhe prezantimin e pasqyrave financiare që janë pa gabime materiale si rrjedhojë e mashtrimeve apo gabimeve të paqëllimshme.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Ministrisë që të vazhdojë aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet e lidhura me vazhdimësinë e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë Ministrinë ose të ndërprejë operacionet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë mënyrë.

Të ngarkuarit me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Qëllimi ynë është marrja e sigurisë së arsyeshme që pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë si pasojë e mashtrimeve ashtu edhe e gabimeve dhe lëshimit të një raporti të auditorëve i cili përmban opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion i asaj që një auditim i kryer në përputhje me INTOSAI, do të detektojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të lindin nga mashtrimet ose gabimet dhe konsiderohen materiale nëse individualisht, ose të bashkuara, mund të pritet në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të shfrytëzuesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me INTOSAI, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e anomalive materiale të pasqyrave të veçanta financiare, si pasojë nga mashtrimet apo edhe si pasojë e gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedura të auditimit të cilat i përgjigjen këtyre risqeve dhe marrim evidenca të auditimit të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Risku i mos-zbulimit të një anomalie materiale e cila rrjedhë nga mashtrimi është më i madh

sesa i atij që rrjedhë nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterepretime, ose shkelje të kontrollit të brendshëm.

- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm i cili është i rëndësishëm për auditimin në mënyrë që të dizajnohen procedura të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni lidhur me efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë.
- Vlerësojmë përshtatshmerinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosje të ngjashme të bëra nga menaxhmenti.
- Bazuar në evidencën e siguruar, vendosim mbi përshtatshmërinë e shfrytëzimit të parimit të vazhdimësisë së biznesit dhe nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të vënë në dyshim aftësinë e Ministrisë për të vazhduar me tutje. Nëse ne konkludojmë se një pasiguri materiale ekziston, jemi të detyruar të tërheqim vëmendje në raportin tonë lidhur me këtë shpalosje në pasqyrat e veçanta financiare, ose nëse shpalosjet e tilla nuk janë të duhurat, të modifikohet opinioni jonë. Konkluzionet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të mbledhur deri me datën e raportit të auditimit. Sidoqoftë, kushtet ose ngjarjet në të ardhmen, mund të shkaktojnë që Ministria të ndërprejë vijueshmërinë e biznesit.
- Vlerësimi i prezantimit të përgjithshëm, strukturës dhe përmbajtjes së pasqyrave financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet themelore dhe ngjarjet në mënyrë që të arrijnë paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisje, mes tjerash, fushëveprimin e planifikuar dhe kohën e auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme të cilat i identifikojmë gjatë auditimit.

Deloitte Kosova shpk.

Deloitte Kosova sh.p.k.

Rr. Lidhja e Pejës, nr.177

Prishtinë, Republika e Kosovës

Numëri i regjistrimit: 80452632

28 qershor 2017

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Ministria kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Raportin për obligimet e papaguara; dhe
- Planin e prokurimit në versionin fillestar dhe final.

Në kontekst të PFV-ve, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Rekomandimi 1 Ministri duhet të sigurojë kontrolla shtesë që mundësojnë menaxhimin e pasurive në përputhje me kërkesat ligjore.

2 Qeverisja

2.1. Hyrje

Aranzimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për Ministrinë që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetë-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një OB të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në vitin 2016, Ministria ka përdorur 96% të buxhet final me një përmirësim për 11% në krahasim me vitin paraprak. Kjo tregon një trend pozitiv në menaxhimin e buxhetit.

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda Ministrisë, siç është detajuar në seksionin 2.3 - 2.6 më poshtë. Sa i përket rekomandimeve të auditimit të jashtëm dhe brendshëm, Ministria ka përgatitur një plan të zbatimit.

2.3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2015 të Ministrisë kanë rezultuar në 10 rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit për vitin 2016, Ministria ka zbatuar 4 rekomandime, përderisa 6 rekomandimet tjera janë në proces të zbatimit. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe si janë adresuar ato, ju lutem shihni Aneksin III.

Çështja 2 – Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i mesëm

E gjetura	Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar.
Rreziku	Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, kanë rezultuar në, pasaktësi të vazhdueshme në prezantimin e pasurive kapitale dhe jo-kapitale.
Rekomandimi 2	Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

2.4 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetë-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetë-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 3 – Pyetësi i vetë-vlerësimit – Prioritet i lartë

- | | |
|----------------------|---|
| E gjetura | Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar katër çështjet kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se sa i përket barazimit të pasurive kapitale sipas SIMFK dhe regjistrit të pasurive kapitale, MAPL është shprehur se përgatitet në baza vjetore, por dokumentacioni mbështetës që kemi marrë rreth kësaj nuk e mbështet këtë përfundim. |
| Rreziku | Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive. |
| Rekomandimi 3 | Ministri duhet të sigurojë se është rishikuar plotësimi i listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. |

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit Ministria operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara të implementojnë një vlerësim të rrezikut. Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, Ministria ka përgatitur një listë të rreziqeve të tilla.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.5.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

Çështja 4 - Dobësi në kontrollet menaxheriale në lidhje me pasuritë jo-financiare dhe PFV - Prioriteti i mesëm

E gjetura	Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të MAPL ka nxjerrë në pah se pavarësisht nga raportimi i rregullt formal nga njësitë vartëse për pasuritë jo-financiare dhe për përgatitjen e PFV dhe, ato nuk përdoren efektivisht nga menaxhmenti për të parandaluar gabime sistematike në këto fusha.
Rreziku	Cilësia e dobët e raportimit financiar në lidhje me pasuritë jo-financiare dhe PFV mund të reduktojë aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet MAPL-së në mënyrë pro aktive.
Rekomandimi 4	Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të parandalojë gabimet në raportimet e cekura më sipër.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe dy auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të MAPL-së dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Çështja 5 - Mos realizimi i plotë i planit të NjAB-së - Prioriteti i mesëm

E gjetura	Katër prej pesë raporteve të planifikuara për vitin 2016 janë kryer.
Rreziku	Një program jo i plotë i auditimit i cili nuk pasqyron rreziqet e hasura nga Ministria ndikon në mos identifikimin dhe mos adresimin e dobësive në kontrolle duke rezultuar në jo efikasitet operativ dhe humbje financiare për Ministrinë. Mos adresimi i rekomandimeve do të përkeqësojë situatën.
Rekomandimi 5	Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti auditimit të brendshëm, Ministri duhet të sigurojë se të gjitha auditimet e planifikuara të realizohen gjatë vitit dhe duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Sa i përket MAPL-së, çështjet tek prokurimi janë zvogëluar dukshëm, pjesërisht për shkak të përmirësimeve në kontrollet e implementuara në Ministri dhe pjesërisht për shkak të delegimit të procedurave të prokurimit tek komunat përkatëse. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar gabimet. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë menaxhimi i pasurive kapitale, ekzekutimi i buxhetit, dhe planifikimi i prokurimeve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Burimet e fondeve	4,960,000	4,988,957	4,808,764	3,825,642	4,259,816
Grantet qeveritare – Buxheti	4,960,000	4,775,476	4,696,680	3,745,283	4,148,756
Donacione të jashtme	-	213,481	112,084	80,359	111,060

Buxheti final është për 28,922 euro më i madh se sa buxheti fillestar. Ndryshimi është për shkak të donacioneve të jashtme prej 213,481 euro dhe zvogëlimit të fondeve i aplikuar pas rishikimit të buxhetit dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë. Ne vitin 2016, MAPL ka përdorur 96% të buxhetit final ose 4,808,764 euro, më një përmirësim prej 11% në krahasim me vitin 2015. Në vijim janë sqarimet për pozitat aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	4,960,035	4,988,957	4,808,764	3,825,642	4,259,816
Pagat dhe Mëditjet	976,455	925,554	918,917	844,722	809,979
Mallrat dhe Shërbimet	254,431	445,916	345,231	326,231	446,250
Shërbimet komunale	25,500	11,959	11,134	13,388	18,878
Subvencionet dhe Transferet	203,649	197,624	197,624	200,732	372,007
Investimet Kapitale	3,500,000	3,407,905	3,335,858	2,440,569	2,612,702

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar është zvogëluar për 50,901 euro. Deri me 31 dhjetor 2016, 99% e buxhetit final është ekzekutuar;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar është rritur për 191,485 euro. Fillimisht u zvogëlua për 7,000 euro me rishikim të buxhetit. Më pas, buxheti është zvogëluar edhe për Euro 14,000. Buxhetit final i janë shtuar edhe 212,481 euro nga donacionet e jashtme. Buxheti final për këtë kategori u ekzekutua 77% ose 345,231 euro;
- Buxheti final për komunalitet në krahasim me buxhetin fillestar është zvogëluar për 13,541 euro. Fillimisht u zvogëlua për 10,000 euro, e më pas edhe për 5,000 euro. Në fund, buxhetit

final i janë shtuar edhe 1,000 euro nga donacionet e jashtme. Buxheti final për këtë kategori u ekzekutua 93%;

- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar është zvogëluar për 6,025 euro. 100% e buxhetit final është ekzekutuar; dhe
- Buxheti final për investimet kapitale është zvogëluar për 92,095 euro në krahasim me buxhetin fillestar. Fillimisht, me rishikim të buxhetit, kjo kategori është rritur për 70,000 euro e më pas u zvogëluar për 162,000 eur. Pas këtij zvogëlimi, buxheti final për këtë kategori u ekzekutua 98%.

Programi për Investime Kapitale përfshin projekte ekzistuese të bartura nga viti i kaluar si dhe projekte të reja të filluara gjatë vitit 2016. Projekti "Rregullimi i shtratit të lumit në Dobrajë të Madhe" Komuna e Lipjanit, si bashkëfinancim në mes të MAPL dhe Komunës së Lipjanit sipas marrëveshjes në shumë prej 157,537 €, nuk ishte finalizuar në vitin 2014 pasi që progresi fizik i projektit nuk ishte në nivelin e pritur, dhe projekti i tillë vazhdoi edhe gjatë vitit 2015 dhe u finalizua në vitin 2016. Gjithsej pagesat e kryera gjatë vitit 2016 për këtë projekt janë 37,612 euro.

Gjatë vitit 2016, një kontratë e re është nënshkruar për blerjen e pajisjeve të teknologjisë informative me Ilir Kosova sh.p.k. dhe Storm ICT l.l.c., me vlerë 68,897 euro dhe 28,750 euro respektivisht. E gjithë shuma e kontraktuar është pranuar gjatë vitit.

Gjithashtu, janë kryer pagesa rreth investimeve kapitale të bashkë – financuara me komunitat (prokurimet e të cilave janë kryer nga ana e komunave) në vlerë prej 249,988 euro, 247,967 euro dhe 198,130 euro me komunën e Mitrovicës, Zubin Potokut dhe Zveçanit, respektivisht.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat e implementuara nga MAPL lidhen me kalkulimin e pagave në përputhje me kontratat e punëtorëve dhe ligjet e aplikueshme.

Numri i punëtorëve të aprovuar nga MAPL është 151, përderisa numri aktual i punëtorëve është 149. Ne kemi testuar disa procedura të rekrutimit, dosje të stafit, kemi rishikuar listat e pagave dhe kemi krahasuar informatat e prezantuara në Thesar, SIMFK dhe prezantimin e tyre në PFV.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Ne kemi testuar shpenzime për të cilat nuk kërkohet aplikimi i procedurave të prokurimit si komunalitë, shpenzimet e përfaqësimit, udhëtimit, dhe shpenzime tjera.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 197,624 euro, të cilat janë realizuar 100%. MAPL ka zhvilluar procedura për monitorimin e subvencioneve dhe transfereve.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për Investimet Kapitale ishte 3,407,905 euro, të cilat janë realizuar 3,335,858 euro.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.5 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Çështja 6 - Planifikim jo i mirë i prokurimeve - Prioritet i lartë

E gjetura	Gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2016, Ministria ka kryer prokurime në vlerë prej 108,660 euro, të cilat nuk ishin të përfshira në planin e prokurimit. Përqindja e prokurimeve të pa planifikuara është më shumë se 60% e vlerës totale financiare të prokurimeve, e cili përfshin 3 nga gjithsej 42 prokurimet e kryera gjatë vitit.
Rreziku	Si pasojë e mos planifikimit të mirë të prokurimeve, mund të rrjedhin vonesa në pranimin e shërbimeve dhe vlerë e dobët për paranë e shpenzuar.
Rekomandimi 6	Ministri duhet të sigurohet se një analizë e detajuar e nevojave të Ministrisë performohet para finalizimit të planit të prokurimit, në mënyrë që prokurimet jashtë planit të zvogëlohen në një nivel më të arsyeshëm.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Edhe pse Ministria ka ndërmarrë hapa për të përmirësuar raportimin rreth pasurive, ka ende pasiguri dhe mangësi në lidhje me pasuritë e Ministrisë. Me poshtë janë gjetjet të cilat nuk janë përfshirë në pjesën e parë të raportit.

Çështja 7 – Mangësi në menaxhimin e pasurisë – Prioritet i lartë

- E gjetura** Mos-barazimi i lëvizjeve në pasuritë jo-kapitale. Balanca e pasurive jo-kapitale sipas shënimit 19.3.2. është rritur për 47,000 euro prej 31 dhjetor 2015. Kjo nuk korrespondon me investimet në pasuri jo-kapitale të kryera gjatë vitit, të prezantuara në shënimin 3 të pasqyrave financiare (specifikisht, kategoritë në shënimin 3 të mobiljeve, telefonave, kompjuterëve dhe pajisjeve tjera të teknologjisë informative – më të vogla se 1,000 euro)
- Rreziku** Mos-mbajtja e informatave të nevojshme kontabël rreth korigjimeve të kryera në balancën e pasurive jo-kapitale ndikon në saktësinë e vlerës së prezantuar në pasqyra të pasurive.
- Rekomandimi 7** Ministri duhet të sigurojë kontrolle shtesë që mundësojnë menaxhimin e pasurive në përputhje me kërkesat ligjore.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve më 31 dhjetor 2016 ishte 17,482 euro. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017. Në krahasim me vitet e kaluara, obligimet e papaguara janë zvogëluar dukshëm. Obligimet e papaguara lidhen me fatura të pranuar në dy ditët e fundit të nëntorit dhe muajin dhjetor 2016.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keq deklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Rekomandimet e vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar dhe marrë parasysh plani i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të bëra nga auditori, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Në proces të zbatimit	
Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Ministri duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.		Në proces të zbatimit	
Vlerësimi i rrezikut	Ne rekomandojmë që Ministri të sigurohet se MAPL është në pajtim me të gjitha kërkesat për raportim, duke përfshirë edhe përgatitjen e regjistrit të rreziqeve.	Të zbatuara		
Raportimi Menaxherial	Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit tek menaxhmenti i lartë, dhe se raportimet përdoren nga menaxhmenti me qëllim të parandalimi të gabimeve.		Në proces të zbatimit	
Sistemi i auditimit të brendshëm	Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm, Ministri duhet të sigurojë angazhim më të madh të Komitetit të Auditimit. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm dhe rezultatet e auditimit të brendshëm. Gjithashtu duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.		Në proces të zbatimit	

Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Ministri duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final	Të zbatuara	
Prokurimi	Ministri duhet të sigurojë se është kryer një shqyrtim për të përcaktuar pse në rastet e mësipërme kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë. Rrjedhimisht, duhen kontrole të shtuara për të siguruar që një situatë e ngjashme nuk do të përsëritet në prokurimet e ardhshme.		Në proces të zbatimit
Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha kompensimet e bëra janë brenda limiteve dhe në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret përkatëse.	Të zbatuara	
Pasuritë dhe detyrimet	Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë menaxhimin e pasurisë në përputhje me kërkesat ligjore. Po ashtu e një rëndësie të veçantë është të inicijojë procesin për heqjen e pasurisë nga regjistri kontabël të cilat nuk janë pronë e Ministrisë		Në proces të zbatimit
Trajtimi i borxheve	Ministri duhet të sigurohet se MAPL do të ndërmarrë hapa të mëtejshëm dhe të hartojë plane veprimi për të kryer pagesat brenda periudhës së kërkuar.	Të zbatuara	

Shtojca IV: Komentet e OB-së për të gjeturat e raportit të auditimit

Të gjetura/ çështjet	Pajtohemi po/jo	Komentet e OB-së në rast të mospajtitimit	Pikëpamja e ZKA-së
